



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

PROJEKT-VENDIM

Nr. 10, datë 16.12.2022.

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 DHE BUXHETIT VJETOR 2023 TË BASHKISË
VAU DEJËS”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024 të Bashkisë Vau Dejës, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Efektet e këtij vendimi janë nga data 1 Janar deri në 31 Dhjetor të vitit 2023.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për marrjen e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Lidhja nr.1

KALENDARI I PËRGATITJES SË PROJEKT PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024

Kalendari PBA & buxhetit vjetor

- Përgatitet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli i njësisë (brenda 31.12. viti 2022);
- Hyn në fuqi dhe shpërndahe te të gjitha njësité shpenzuese nga kryetari i njësisë (1.01.2023).

Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01. viti 2023);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. viti 2023).

Tavanet e shpenzimeve të PBA në nivel programi

- Kryetari i njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. viti 2023);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. viti 2023);
- Kryetari i njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i tavanëve);
- Udhëzimi shpërndahe te njësité shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve / 20.03. viti 2023);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill (korrik viti 2023);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07.viti 2023);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërndahe te të gjitha njësité shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare / 25.07. viti 2023).

Kërkesat sipas tavanëve buxhetore

- Njësité shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përgatitore te Njësia e Menaxhimit të Programeve (prill.viti t) dhe japin argumente për fonde / tavane shtesë;
- Njësité shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përfundimtare (1.08. viti 2023).

PBA & Buxheti vjetor

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin I të PBA viti t+1, t+2, t+3 (30.05.2023)
- Kryetari i njësisë dërgon MFE PBA (1.06. viti 2023); •MFE-ja dërgon opinionion e saj mbi PBA-në te njësia vendore (20.06. viti 2023);
- Kryetari i njësisë vendore dërgon PBA-në së bashku me opinion e MFE-së për miratim në Këshill (21.06. viti 2023);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA-së (30.06. viti 2023);
- Kryetari publikon PBA / dokumentin I (5.07 viti 2023);
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së (10. korrik viti 2023);
- Njësia rishikon PBA-së (korrik - gusht viti 2023);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. viti 2023);
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar te MFE-ja 15.09.2023
- MFE-ja zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2023);
- MFE-ja dërgon opionin përfundimtar sipas rastit te njësia vendore (20.10.2023);
- Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA-në dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2023);
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor (25.12.2023);
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese (31.12.2023).

Përgjegjësi i Buxhetit dhe Financës

Albert Ndoci

Kryetari i Bashkisë

Mark Babani

